



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

Nr. 452/2022  
Datë: 26.12.2022

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1 dhe 2.9), të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Z. Arben Vitia emërohet Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, me legjislacionin në fuqi, si dhe kryen detyra tjera shtesë të caktuara nga Kryeministri.
3. Ministri, është i obliguar të bëjë deklarin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi Nr. 391/2022, i datës 07.10.2022.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë;
- Znj. Dafina Gexha – Bunjaku, u.d. e Ministres së Ministrisë së Shëndetësisë;
- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të Stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.